



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2025:000475

Datë: 18.03.2025

Numri i dokumentit: 07009538

Ep.nr.02/25

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Drilon Hoxha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N.... BANKA Sh.A. me seli në Prishtinë, ndaj debitorve: NNTE “A.” BI, me pronar E. P., nga Fshati V., Komuna Pejë, të cilin me autorizim e përfaqëson Arben Kelmendi, avokat në Pejë, dhe B. P., me adresë të banimit në Fshatin V., Komuna Pejë, në bazë të Marrëveshjes mbi kredinë dhe Kontratën e Hipotekës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të parë, kundër urdhrit të Përmbartuesit M. S. R., P.nr.415/24 të datës 05.12.2024, pas mbajtës së seancës dëgjimore, me datë 18.02.2025 mori, kurse me datë 18.03.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET si i themeltë prapësimi i debitorit N.N.T “A.” me pronar E. P., ashtu që ANULOHET Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.415/24, i datës 05.12.2024, si dhe te gjitha veprimet përmbartimore të ndëmarrura në këtë procedurë si të palejueshme.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Kreditori, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të përmbartimor, marrëveshjes mbi kredinë dhe kontratën e hipotekës, me bazë juridike: borxh në vlerë prej 45,220.78€.

Përmbartuesi Privat M. S. R. duke vepruar në bazë të propozimit të kreditorit me Urdhrin P.nr.415/24 të datës 05.12.2024 e ka lejuar përmbartimin e propozuar.

Brenda afatit ligjor prapësim ka paraqitur debitori i parë NNT “ A.” B.I, përmes të autorizuarit të tij, duke e kundërshtuar urdhërin për lejimin e përmbartimit, ka shtuar se të njëjtit nuk kanë lidhur asnjëherë marrëveshje mbi kredinë dhe kontratë mbi kredinë, se propozimit i mungojnë provat e specifikuar si në plotësim propozimin, ka shtuar se e njoftojmë gjykatën se debitori B. P. ka vdekur me datë 06.11.2008 dhe se i njëjti nuk mund të jetë palë si në propozimin e kreditorit, dhe se kërkesa është e parashkruar, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi propozimi i kreditorit si i parashkruar, shpenzimet e procedurës përmbartimore i ka kërkuar të specifikuar.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimi, ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i ushtruar nga ana e debitorit N.N.T “ A.”.

Gjykata, pas mbajtës së seancës dëgjimore në procedurën përmbartimore, dhe pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është i bazuar.

Në rastin konkret në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se Gjykata e ka lejuar përmbartimin në bazë të aktvendimit me E.nr.152/13 me datë 13.02.2013, ndaj debitorit N.N.T “A.” në bazë të aktgjykimit C.nr.28/2005 i plotëfuqishëm që nga data 11.02.2009, dhe i cili aktgjykim ka ardhur si rezultat i mospërmbushjes së kredisë së datës 05.04.2004 e cila kontratë gjindet në shkresat e lëndës. Me datë 03.12.2024, kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim, i cili me datë 05.12.2024 është lejuar nga ana e përmbartuesit privat tashmë në bazë të kontratës për kredi të datës 05.04.2004(nga e cila kontratë ka rrjedhur edhe aktgjykimi i lartëcekur) dhe kontratës mbi hipotekë të datës 05.04.2004 ndaj debitorëve N.N.T “ A.” me pronar E. p., dhe debitorit B. P. për realizimin e kërkesës (kredisë) në shumën prej 45,220.78 euro

Gjykata duke marrur parasysh se aktvendimi i gjykatës i datës 13.02.2013 me të cilin është lejuar përmbartimi është i formës së prerë për shkak se ndaj tij nuk është paraqitur prapësim, dhe duke marrur për bazë faktin se për të njëjtën qështje është në zhvillim procedura përmbartimore, e cila

gjindet në fazën e ekzekutimit, konsideron se propozimi për përmbarrim nuk ka mundur të paraqitet tashmë në bazë të kontratës për kredi të datës 05.04.2004, për arsye se në bazë të aktgjykimit C.nr.28/2005 është lejuar përmbarrimi, dhe se përmbarrimi nuk mund të kërkohet për kërkesën e njëjtë, njëherë në bazë të aktgjykimit dhe pastaj në bazë të kontratës për kredi (nga e cila kontratë ka derivuar ky aktgjykim).

Me dispozitën e nenit 22 par.1 pika 1.7. parashihet se ndër të tjera si dokument përmbarrues është edhe: *“kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”*. Andaj duke marrur parasysh faktin se kontrata mbi kredinë nuk është dokument përmbarrues në bazë të dispozitave të nenit 22 të LPP-së, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë kontratë mbi hipotekën në të cilën është thirrur kreditori, dhe një e drejtë e tillë nuk figuron të jetë as e regjistruar në librat publik, gjykata vlerëson se nuk kanë qenë të plotësuar kushtet për lejimin e përmbarrimit.

Duke marrur parasysh se me prapësim dhe në seancën dëgjimore është vënë në dyshim fakti lidhur me debitorin i dytë, se i njëjti është në jetë apo ajo, për vërtetimin e këtij fakti, gjykata ju ka drejtuar Zyrës së gjendjes civile në Komunën e Pejës, e cila e ka konfirmuar vdekjen e të njëjtit, duke bashkangjitur edhe certifikatën e vdekjes me nr të referencës 17/..... e datës 06.03.2025, me anë të së cilës vërtetohet fakti se debitori B. Prekaj ka vdekur me datë 06.11.2008.

Tek detyrimet të cilat janë të bartshme në raport me trashëgimtarët të cilët disponojnë me pasurinë e trashëgimlënësit, siç kemi të bëjmë edhe me rastin konkret, ligjërisht procedura përmbarrimore sipas propozimit të kreditorit mund të fillohet në raport me trashëgimtarët e tij duke u emëruar në propozim me emër dhe mbiemër, por në asnjë rrethanë në raport me një person i cili nuk është në mesin e të gjallëve siç ka ndodhur me rastin konkret, për arsye se i njëjti as nuk mund të jetë palë në procedurë me çka nën rrethanën e tillë, gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret nuk kanë qenë të plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarrimit ndaj debitorit, tani të ndjerit B. P. i cili ka vdekur para se të ushtrohet propozimi për përmbarrim.

Pra, këtu kemi të bëjmë me aftësinë për të qenë palë në procedurë. Aftësia për të qenë palë është ajo aftësi për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrave në emër të vet. Aftësia për të qenë palë korrespondon me aftësinë juridike nga e drejta materiale. Ai i cili ka aftësi juridike nga e drejta materiale ka edhe aftësi për të qenë palë në procedurë. Aftësinë për të qenë palë në procedurë në

bazë të nenit 73 par. 1 të LPK e ka secili person fizik. Personi fizik e fiton aftësinë për të qenë palë sikurse edhe aftësinë juridike me lindjen e tij, ndërsa aftësia juridike e personit fizik përfundon me vdekjen e tij.

Me dispozitën e nenit 31 paragrafi 2 të LPP shprehimisht përcaktohet se: *“Përmbarimi caktohet edhe kundër personit të tretë i cili në dokumentin përmbarimor nuk përmendet si debitor, po qe se kreditori me anë të dokumentit publik apo privat, por të vërtetuar sipas ligjit provon se personi i tillë në mënyrë të ligjshme e ka marrë përsipër borxhin (debinë) nga dokumenti përmbarues, apo se ai borxhin e tillë sipas ligjit është i detyruar ta shlyejë. Po qe se kontestohet detyrimi i personit të tretë për marrjen përsipër të borxhit, atëherë palët para se të lejohet përmbarimi, kontestin duhet ta zgjidhin në procedurë kontestimore”*.

Me dispozitën e nenit 38 paragrafi 1. Të LPP shprehimisht përcaktohet: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës ne mbështetje të dispozitave të lartëcitura kreditori më qëllim të realizimit të kredisë së tij sipas dokumentit përmbarimor, para se të ushtronte propozimin për përmbarim, është dashur që paraprakisht të sigurohet se a është ne jetë debitori apo jo, dhe më të kuptuar për faktin e vdekjes së debitorit nuk ka pas pengesa ligjore që përmbarimin ta ushtronte ne drejtim të trashëgimtareve të të ndjerit B. P., apo personit i cili disponon me pasurinë e tij që është objekt i hipotekës së pretenduar, dhe pas plotësimit të këtij prezumimi që ka të bëjë me cilësinë e palës që të jetë palë në procedurë, atëherë të vlerësohet se debitori i dytë a ka lidhur kontratë mbi hipotekën me këtu kreditorin, si dhe propozimi për përmbarim duhet të jetë konform me dispozitën e nenit 38 paragrafi 1 të LPP, më qëllim që në këtë mënyrë përmbarimi të mund të fillohet, caktohet dhe zbatohet ndaj personave të cilët do të kishin cilësinë e palëve debitorë në procedurë.

Gjykata ka pas parasysh edhe pretendimet tjera për të cilat ka gjetur se janë pa ndikim për një vendosje ndryshe të kësaj çështje.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur pas mbajtjes së seancës dëgjimore e duke u bazuar në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 të LPP-së.

Andaj nga të lartëcekurat e duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 17 të LPP-së e në lidhje me nenin 73 par.1 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
Ep.nr.02/25, me datë 18.03.2025

Gj y q t a r i
Drilon Hoxha

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimin të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.